



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 07.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUARNGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR POPULLSINË”

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e **komisionit për dhënie mendimi**, në mbledhjen e datës 07.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Albana Fico, drejtore e Institutit të Shëndetit Publik, znj. Antoneta Njehrrëna, drejtor juridik dhe Dr. Alban Ylli, specialist pranë Institutit të Shëndetit Publik.

Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së bashkëfinancimit, e cila është miratuar me vendimin nr.420, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave.

Kjo marrëveshje pritet t'i hapë rrugë përfundimit të studimit të ADHS. Ky studim pritet të realizohet në një kampion të madh dhe përfaqësues të popullatës dhe të ofrojë të dhëna të vlefshme demografike dhe shëndetësore për shumë grup moshë dhe kategori të rëndësishme të popullatës, të dhëna që nuk ofrohen nga të dhënat administrative dhe nga studime të tjera. Ky studim përfshin grup moshat dhe kategoritë, si: fëmijët e moshës 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese, individët në moshë madhore të të dyja gjinive 15-59 vjeç dhe siguron informacion për vlerësimin e programeve ekzistuese në vendin tonë.

Pas këtij studimi pritet që të ofrohet informacioni i nevojshëm jo vetëm për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe për ministri të tjera, lidhur me hartimin e politikave dhe strategjive të reja, si dhe modifikimin e programeve ekzistuese lidhur me shëndetin dhe shërbimet shëndetësore dhe sociale që i ofrohen popullatës shqiptare.

Efektet financiare

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të përmbushë me fondet e saj buxhetore mbulimin e fondit të nevojshëm prej 22.5 (njëzet e dy pikë pesë) milionë lekësh.

Diskutime në Komision

Të ftuarit në komision, prezantuan të gjithë ecurinë dhe rezultatet e studimit për çrregullimin e vëmendjes së deficitit të hiperaktivitetit (ADHS). Kryerja e plotë e studimit ADHS 2017-2018 kërkon një buxhet total prej 167 111 153 lekësh.

Duke marrë në konsideratë kontributet e partnerëve ndërkombëtarë (SDC/HAP, UNFPA, UNICEF, UN Women) dhe të institucioneve kombëtare (ISHP dhe INSTAT), shpenzimet e kryera, parashikimet e shpenzimeve deri në përfundimin me sukses të studimit (duke marrë parasysh edhe ndryshimet në kurset e këmbimit valutor nga të paktën tri monedha (CHF, USD, ALL), rezulton se fondi i pambuluar për përfundimin e ADHS-së është në total 300 000 USD (ose 33 500 000 lekë.)

Gjatë prezantimit, deputetët u interesuan mbi risitë që sjell për Republikën e Shqipërisë zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe vlerësuan rezultatet e deri më tanishme të studimit.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkërendim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë shprehur dakord për këtë marrëveshje bashkëfinancimi.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

MIMI KODHELI